



Datë: 28.04.2025

Numër Protokolli: 2835/2025

A.nr.471/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.471/2025, të datës 14.03.2025, të parashtruar nga ankuesja D.U., kundër organit të punësimit/Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.471/2025, e datës 14.03.2025, e parashtruar nga ankuesja D.U.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, D.U. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 14.03.2025, ka parashtruar ankesë në e-mailin zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net, e cila ankesë protokolluar me numër 1713/2025 dhe regjistruar me numër A.nr.471/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit me numër protokolli 868 të datës 07.03.2025, lidhur me refuzimin e aplikacioni të punësimit, për procedurën e rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00016448, për pozitën e punës “*Zyrtar i lartë për diagnostikimin e patogjeneve në ushqime*” në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa, kjo e fundit, me datë 15.04.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)

nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datë 23.01.2025, ka publikuar Njoftimin për shpalljen e Konkursit me numër reference RN00016448, për pozitën e punës “Zyrtar i lartë për diagnostikimin e patogjeneve në ushqime”, me afat aplikimi nga data 24.01.2025 deri më datë 22.02.2025.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja ka aplikuar në procedurën përkatëse të rekrutimit, mirëpo sipas Njoftimit numër protokolli 868 të datës 07.03.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, rezulton se të njëjtës i është refuzuar aplikacioni i punësimit, me arsyetimin se nuk ka bashkangjitur dokumentacionin e kërkuar sipas pikës 5 të konkursit, lidhur më dëshmimin e përvojës së punës.

Andaj, kundër Njoftimit të datës lartë theksuara, lidhur me rezultatet e refuzimit të aplikacionit të punësimit, ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshill, duke kërkuar aprovimin e ankesës dhe vazhdimin tutje në procedurat e rekrutimit.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 ku përcaktohet se: *12. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*

Referuar kuadrit ligjor përkatës si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesja më datë 14.03.2025, kundër Njoftimit me numër protokolli 868 të datës 07.03.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me refuzimin e aplikacionit, është e parakohshme, ngase sipas dispozitave përkatëse ligjore, kandidati për pranim në shërbim civil ka të drejtë të parashtrtoj ankesë vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesja ka dorëzuar ankesën ende pa u publikuar rezultatet përfundimtare të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016448, për pozitën e punës “Zyrtar i lartë për diagnostikimin e patogjeneve në ushqime”.

Andaj, theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e dorëzuar nga ankuesja me datë 14.03.2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa u publikuar ende rezultatet përfundimtare lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është e parakohshme në kuptim të dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e njëjta është e papranueshme, kështu që, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin

Civil të Kosovës, vendosi të hedhë poshtë si të parakohshme ankesën A.nr.471/2025, të datës 14.03.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.471/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses D.U.;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.